



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 73

Tiranë – E martë, 21 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 20/2019 datë 28.3.2019	Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” 5439
Vendim i Kuvendit nr. 56/2019, datë 16.5.2019	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 175, datë 19.4.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 20/2019 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’” 5440
Vendim i Kuvendit nr. 57/2019, datë 16.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar 5440
Vendim i Kuvendit nr. 58/2019, datë 16.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” 5442
Vendim i Kuvendit nr. 59/2019, datë 16.5.2019	Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të vitit 2019..... 5443
Vendim i Kuvendit nr. 60/2019, datë 16.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për qeverisjen vendore’, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar..... 5443
Rezolutë e Kuvendit datë 16.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018..... 5444
Rezolutë e Kuvendit datë 16.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2018..... 5446

Rezolutë e Kuvendit datë 16.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për vitin 2018.....	5448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 15.5.2019	Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut.....	5449
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 9, datë 14.5.2019	Për përcaktimin e procedurave të administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas.....	5450
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 437, datë 16.5.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	5451
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5121/1, datë 16.5.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dhamo’, Lushnjë”.....	5454
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7263, datë 16.5.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjes.....	5454
Vendim i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1, datë 21.5.2019	Mbi shfuqizimin e kompetencave të deleguara me vendimin nr. 244, datë 22.12.2018, “Për delegim kompetence të kryetarit të KLSH-së”.....	5454
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja.....	5455



LIGJ
Nr. 20/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 12/2018 “PËR VLERËSIMIN
KALIMTAR DHE PERIODIK TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS
DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E
BRENDSHME DHE ANKESAT NË
MINISTRINË E BRENDSHME”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. “Organet e vlerësimit kalimtar” janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

2. Pika 21, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Organet e vlerësimit kalimtar janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit organizohet në trupa vlerësimi, të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe janë përgjegjëse për verifikimin, vlerësimin, si dhe për marrjen e vendimeve ndaj punonjësve.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit mbështetet gjatë veprimtarisë së tij nga një sekretariat teknik, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “b”, ndryshohet si më poshtë:

“b) komandant, zëvendëskomandant dhe kolonel në Gardën e Republikës;”.

2. Në pikën 1, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat vlerëson të gjithë punonjësit e tjerë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës.”.

4. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.”.

Neni 5

Nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 24, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit drejtohet nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë, i caktuar prej tij.”.

Neni 7

Në nenin 29, pika 4, shfuqizohet.



Neni 8

1. Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, fjalët “komisionet e vlerësimit” zëvendësohen me fjalët “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit” dhe fjalët “sekretariateve teknike” zëvendësohen me fjalët “sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”.

2. Në të gjithë ligjin, në nenet nga 31 deri në 62, pas fjalëve “trupa e vlerësimit” shtohen fjalët “ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

Neni 9

Neni 68, shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 28.3.2019

VENDIM
Nr. 56/2019

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 175, DATË 19.4.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 20/2019 ‘PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 12/2018 ‘PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME””

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 175, datë 19.4.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 20/2019 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.5.2019.

VENDIM
Nr. 57/2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 34, DATË 20.5.2010, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.5.2019.



Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS
TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

I. Komisioneri	1	I-D
		Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010
II. Kabineti	2	
Këshilltar	1	II-b
Sekretar	1	VKM 187/2017, pika 6
III. Drejtoria e Pritjes së Ankesave	6	
Drejtor	1	II-b
Specialist	2	IV-a
Specialist – Shkodër	1	IV-a
Specialist – Korçë	1	IV-a
Specialist – Fier	1	IV-a
IV. Drejtoria e Hetimit Administrativ	6	
Drejtor	1	II-b
Inspektorë	5	III-a
		VKM nr. 107, datë 6.3.2019, shkronja “dh”
V. Drejtoria Juridike	5	
Drejtor	1	II-b
Specialist	4	III-b
VI. Drejtoria e Monitorimit, Raportimit dhe	6	
Komunikimit		
Drejtor	1	II-b
Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë	1	III-b
Specialistë të Monitorimit dhe Raportimit	2	III-b
Specialist i Komunikimit me Mediat	1	III-b
Specialist i Jetësimit të Projekteve	1	III-b
VII. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	8	
Drejtor	1	II-b
Specialist i burimeve njerëzore	1	III-b
Specialist IT	1	III-b
Specialist i Buxhet-Financës	1	III-b
Specialist i Arkiv-Protokollit	1	IV-a
Magaznier/punonjës mirëmbajtje	1	Kl. (VKM nr.717,dt.6.2009), i ndryshuar
Shofer	1	Kl. (VKM nr.717,dt.6.2009), i ndryshuar
Pastrues	1	Kl. (VKM nr.717,dt.6.2009), i ndryshuar

Gjithsej:**34 punonjës**



VENDIM
Nr. 58/2019

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 98/2014
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL”

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 98/2014 ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.5.2019

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,

Lidhja nr. 2

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONERIT PËR
MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS	NUMRI
I. KOMISIONERI		1
KABINETI		(2)
KËSHILLTAR		1
SEKRETAR		1
II. DREJTORIA E PËRGJITHSHME		(15)
E INSPEKTIMIT DHE		
MBIKËQYRJES		
DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a	1
II/1. DREJTORIA E INSPEKTIMIT		(7)
DHE HETIMIT ADMINISTRATIV		
DREJTOR	II-b	1
INSPEKTOR	III-a	6
II/2.DREJTORIA E MBIKËQYRJES		(7)
DREJTOR	II-b	1
INSPEKTOR	III-a	6
III. DREJTORIA E ÇËSHTJEVE		(5)
JURIDIKE DHE		
MARRËDHËNIEVE ME JASHTË		
DREJTOR	II-b	1
SPECIALIST	III-b	4
IV. DREJTORIA E FINANCAVE		(8)
DHE SHËRBIMEVE		
MBËSHTETËSE		
DREJTOR	II-b	1



SPECIALIST (IT)	III-b	1
SPECIALIST(MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN & BURIMET NJERËZORE)	III-b	1
SPECIALIST (FINANCË/BUXHET)	III-b	1
SPECIALIST (ARKIV/PROTOKOLL)	IV-b	1
PUNONJËS MIRËMBAJTJEJE		1
SHOFER		1
PASTRUES		1
PUNONJËS GJITHSEJ		31

**VENDIM
Nr. 59/2019**

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR
FINANCIMIN E PARTIVE
PJESËMARRËSE
NË ZGJEDHJET E ORGANEVE TË
QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 87, pika 1, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Sasia e fondit nga buxheti i shtetit, që do t’u ndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të vitit 2019, është 65 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 16.5.2019.

**VENDIM
Nr. 60/2019**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 99/2017 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT ‘PËR
QEVERISJEN VENDORE’, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E
NJERIUT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për qeverisjen vendore’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Adnor Shameti caktohet anëtar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 16.5.2019.



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2018****Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- Duke konsideruar që një ndër objektivat kryesorë të AMA-s është që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimet fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias;

- Duke theksuar faktin që mbyllja e transmetimeve analoge, në shtator 2018, krijoi një situatë të vështirë për qytetarët shqiptarë, ku u identifikuan radhë të gjata në pikat e shitjeve të dekoderave dhe paqartësi lidhur me teknologjinë e dekoderave;

- Duke theksuar faktin që AMA duhet të kishte qenë proaktive në marrjen e informacionit nga operatorët tregtarë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi numrin e aparateve televizive dhe dekoderave të sistemit DVB-T2, të importuar, si dhe numrin gjendje të tyre në 3-mujorin e fundit të vitit 2018;

- Duke konsideruar procesin e digjitalizimit si një proces shumë të rëndësishëm, i cili i hap rrugë futjes së teknologjive të reja, ofrimit të shërbimeve të reja inovative, me cilësi më të lartë për qytetarët, si dhe përdorimit sa më efektiv të spektrit të frekuencave;

- Duke theksuar faktin që, në krahasim me vitet e mëparshme, aktivitetet e paligjshme audiovizive, pa licencimin ose autorizimin e AMA-s, janë në rënie;

Mori në shqyrtim veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe:

- Vlerëson mbylljen në shtator 2018, për herë të parë, të të gjitha transmetimeve të paligjshme audiovizive numerike, analoge, si dhe audio, një

problematikë 20-vjeçare prezente në qendrat kryesore urbane të vendit.

- Vlerëson lirinë e brezit 790-862 MHz ose ndryshe 800 MHz, i cili, megjithëse i vonuar, është një hap i rëndësishëm, që i hap rrugë futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja *broadband mobile* në nivel kombëtar.

- Vlerëson iniciativën e AMA-s së bashku me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit: gazetarë, drejtues mediash, shoqatat dhe organizatat e tyre, anëtarë të Parlamentit, profesorë të gazetarisë, institucionet shtetërore, lidhur me mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

- Vlerëson nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit mes AMA-s me disa institucione, në mënyrë të veçantë memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës, i cili do të ketë një ndikim pozitiv në vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në fushën e mediave audiovizive.

- Vlerëson punën e bërë lidhur me miratimin e një sërë aktesh nënligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në dinamikën e tregut dhe performancën e OSHMA-ve; në mënyrë të veçantë vlen të përmendet miratimi i rregullores për reklamat dhe komunikimet me natyrë tregtare, i cili ka rritur efikasitetin në evitimin e shkeljeve apo neglizhencave nga OSHMA-të.

- Vlerëson punën e bërë për marrjen e masave për eliminimin e interreferencave që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë.

- Vlerëson punën e AMA-s në pasqyrimin me transparencë të aktivitetit institucional në faqen e saj zyrtare në internet dhe inkurajon që të vijojë përditësimin e informacionit për publikun dhe palët e interesuara, në mënyrë të veçantë të informacionit lidhur me ankesat.

- Vlerëson shqyrtimet tematike për vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe zbatimit të Kodit të Transmetimit për përmbajtjet e emetuara nga OSHMA-të.

- Vlerëson se Këshilli i Ankesave, i ngritur në vitin 2016, ka pasur një ndikim pozitiv në punën e Autoritetit dhe ka vijuar të funksionojë si një organ këshillimor, për të rritur mbikëqyrjen e



Autoritetit ndaj përgjegjësisë së subjekteve audiovizive, për respektimin e normave morale, etike dhe dinjitetit, të drejtës së privatësisë dhe të drejtave themelore të njeriut gjatë ofrimit të shërbimeve për publikun.

- Vlerëson rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të AMA-s, që i shërben forcimit të profesionalizmit dhe pavarësisë operacionale të Autoritetit rregullator, kërkesë kjo edhe e raporteve ndërkombëtare.

- Vlerëson krijimin e grupeve të përbashkëta të kontrollit mes AMA-s dhe AKEP-it për identifikimin e piraterisë televizive të ushtruar përmes rrjetit internet.

Rekomandon për vitin 2019:

- Të vijojë fushatën e informimit të qytetarëve deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, fushatë e cila duhet të përmbajë informacione sa më praktike, me gjuhë sa më të thjeshtë, ilustrime konkrete dhe imazhe mbi teknologjinë që duhet përdorur dhe duke theksuar se tregu i dekoderave DVB –T2 është treg i hapur dhe këta dekoderë mund të sigurohen në çdo pikë shitjeje të pajisjeve elektronike.

- Të bëjë një analizë të plotë të situatës së krijuar nga mbyllja e transmetimeve analoge, në shtator 2018, situatë e cila krijoi vështirësi për qytetarët shqiptarë, ku u identifikuan radhë të gjata në pikat e shitjeve të dekoderave dhe paqartësi lidhur me teknologjinë e dekoderave.

- Të marrë masat e nevojshme, duke bërë një vlerësim paraprak të situatës, në mënyrë që në afatin e ri të vendosur për mbylljen e transmetimeve analoge, të mos kemi përsëritje të situatës së vështirë që u krijua për qytetarët në shtator 2018 dhe qytetarët të jenë të parapërgatitur dhe të mirinformuar, pasi bëhet fjalë për qarqet ku është përqendruar numri më i madh i popullsisë.

- AMA të bashkëpunojë me institucionet përkatëse, shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë në arritjen e rezultateve konkrete për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, shqetësim i cili theksohet në mënyrë të veçantë edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare (rekomandime të BE-së, raporti *Freedom House* 2018, *Reporters Without Borders* etj.), si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

- AMA të përmbushë detyrimet ligjore dhe të bashkëpunojë ngushtë me operatorët audiovizivë në treg dhe të mbajë të informuar në mënyrë periodike Kuvendin e Shqipërisë për mbylljen e transmetimeve analoge.

- Të konkretizohet bashkëpunimi me AKEP-in dhe institucionet të tjera ligjzbatuese kundër piratërisë *online*.

- Të marrë masa për transpozimin (reflektimin) e ndryshimeve të miratuara në legjislacionin e BE-së në fushën e mediave, në legjislacionin e brendshëm, me qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së.

- Bazuar në ndryshimet ligjore të vitit 2018, në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar, të ketë në fokus monitorimin e publicitetit për pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, krahas fokusit të AMA-s në tre fushat kryesore: atë të monitorimit të reklamave tregtare në lajmet informative, produkteve mjekësore dhe mbrojtjes së fëmijëve.

- Të monitorohen më shumë në televizionet shqiptare rastet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të bashkëpunojë me organizata të ndryshme dhe shoqërinë civile për përmirësimin e raportimit për fëmijët.

- Të finalizojë marrëveshjen e bashkëpunimit me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së institucionit, në lidhje me reklamat dhe me konsumatorët, si dhe përmirësimin e standardeve për një treg audioviziv të lirë dhe në përputhje me standardet evropiane.

- Një bashkëpunim më të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Autoritetin e Konkurrencës, veçanërisht në kushtet kur edhe në disa raporte ndërkombëtare theksohet që pronësia e mediave elektronike është përqendruar në duart e disa biznesmenëve të mëdhenj, si dhe ndikimit të interesave ekonomikë dhe politikë, në media etj. Gjithashtu, shfuqizimi i nenit 62, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që përcaktonte kufizimin e sasisë së aksioneve, bën të domosdoshëm një bashkëpunim më të ngushtë me AK-në.

- Vëmendje maksimale për çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, për t’i dhënë përgjigje, duke i vlerësuar me seriozitet dhe për



t'i shërbyer interesit publik në transmetimet audiovizive shqiptare.

- Për të garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive edhe pas kalimit në transmetimet numerike, AMA duhet të jetë më aktive në zgjidhjen e problematikave lidhur me subjektet audiovizive që mbështesin programin e tyre në rrjetin e RTSH-së, të cilat pretendojnë se tarifat e miratuara për mbështetje në rrjetin numerik të RTSH-së janë të pabazuara në kostot reale të RTSH-së.

- Shtimin dhe intensifikimin e tryezave tematike, dëgjësive me grupe të ndryshme interesi mbi përmbajtjen e Kodit të Transmetimit, sensibilizimin për ta respektuar atë, si dhe për tema që rrjedhin nga zhvillime të ndryshme teknologjike dhe mediatike. Sinergji midis KA-së dhe organizatave qeveritare në mbrojtje të fëmijëve, si dhe me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” etj.

- Ndjekjen në vijim deri në zbatimin e tij të plotë të detyrimit ligjor të operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave.

- Vijimin e punës për hartimin dhe miratimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor, përmes miratimit të akteve të reja rregullatore, apo hartimin e ndryshimeve ose shtesave në aktet nënligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator në fuqi. Të garantohet barazi dhe transparencë në trajtimin e aplikimeve, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në aspekte të veçanta, si për transparencën dhe konkurrencën në median elektronike.

- Konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me KPM-në e Kosovës dhe me vendet shqipfolëse.

Miraturar në datën 16.5.2019.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

- Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

- Duke vlerësuar se statistikave zyrtare shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

- Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2018 në drejtim të:

- Përmirësimin të kuadrit ligjor, mbi të cilin INSTAT-i ushtron veprimtarinë e tij, pozicionimin e tij në një shkallë më të lartë hierarkie, forcimin e pavarësisë profesionale dhe mandatit për hyrjen në të dhënat administrative dhe zgjerimit të autonomisë në përdorimin e burimeve të veta.

- Përgatitjes së strategjisë së Censit të ardhshëm të Popullsisë e Banesave, draftit final të pyetësorit të Censit, si dhe përgatitjes së projektligjit për Censin e Popullsisë dhe Banesave.

- Angazhimit në ngritjen e Qendrës së Trajnimit Statistikor në bashkëpunim me ASPA-n, për trajnimin e institucioneve publike mbi njohuritë statistikore dhe hartimit të planeve mbi rritjen e kapaciteteve profesionale të statistikienëve.



- Forcimit të bashkëpunimit me ministritë e linjës apo institucione të tjera publike, me botën akademike dhe median, si dhe publikimin për herë të parë të revistës së tij shkencore “Kërkimi”.

- Testimit të mënyrave të reja të mbledhjes së të dhënave dhe përdorimit gjithmonë e më shumë të të dhënave administrative.

- Realizimit të aktiviteteve të reja statistikore për t’iu përgjigjur sa më të mirë kërkesave në rritje të përdoruesve, si dhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore.

- Progresit të bërë në shumë fusha statistikore me fokus përputhshmërinë e Sistemit Kombëtar Statistikor me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane.

Kuvendi kërkon që Instituti i Statistikave, për vitin 2019, të fokusojë punën në këto drejtime:

1. Të përfundojë pilotimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe të marrë të gjitha masat përgatitore që sigurojnë kryerjen e tij me sukses vitin e ardhshëm, si aktiviteti kryesor dhe më kompleks statistikor që zhvillohet në nivel vendi. Një plan i detajuar për kryerjen e Censit t’i bashkëngjitet planit vjetor 2020 që miratohet në Kuvend.

2. Të përditësojë bazën ligjore dhe të bëjë përcaktimet e sakta, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në çdo material të publikuar nga INSTAT-i në faqen *online* ku citohen vendime dhe ligje të shfuqizuara si: Rregullorja e Brendshme e INSTAT-it, Struktura Organizative, Strategjia e Zhvillimit të INSTAT-it 2017–2030, [Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021](#) etj.

3. Të marrë masa që pas konstituimit të mandateve të anëtarëve, Këshilli i Statistikave të përmbushë me përpikëri rolin dhe detyrat, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare” e të japë kontribut konkret në realizimin sa më të plotë të misionit dhe objektivave të INSTAT-it.

4. Të bëjë publikimin e vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli i Statistikave dhe Bordi Drejtues i INSTAT-it, në funksion të transparencës dhe informimit, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

5. Të përgatisë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, me synim përmbushjen e detyrimeve të Eurostat për

forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe zbatimin e parimeve statistikore evropiane. Strategjia të shoqërohet me një plan konkret veprimi për përmbushjen e saj.

6. Të vlerësojë statistikatat e prodhuara nga ministritë dhe agjencitë e tjera statistikore dhe, duke marrë parasysh mendimin e Këshillit të Statistikave, të krijojë një listë më të gjerë të statistikave zyrtare, duke rritur numrin e të dhënave të transmetuara në Eurostat, si mënyrë për të rritur nivelin e përputhshmërisë me standardet evropiane. Programi pesëvjeçar duhet të përshtatet për të mbuluar këtë listë më të gjerë të statistikave zyrtare.

7. Të forcojë rolin koordinues dhe komunikimin, duke krijuar një komitet të prodhuesve të statistikave zyrtare, i cili të sigurojë zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave në të gjithë Sistemin Kombëtar Statistikor.

8. Të propozojë ndryshime ligjore nëse gjykon se cenohet konfidencialiteti statistikor nga legjislacioni dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi, si ligji “Për arkivat” dhe ligji “Për të drejtën e informimit”, për të vendosur një balancë ndërmjet ruajtjes së konfidencialitetit statistikor dhe së drejtës për informim.

9. Të vijojë përafrimin e legjislacionit shqiptar për statistikatat zyrtare, në përputhje me parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe parimet themelore të statistikave të prodhuara nga Kombet e Bashkuara.

10. Të përmirësojë në vazhdimësi imazhin e institucionit dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikatat zyrtare. Të krijojë një sistem të grupeve të përhershme të përdoruesve, për konsultime periodike, me synim për t’iu afruar gjithnjë e më tepër pritshmërive të përdoruesve, duke respektuar parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

11. Të forcojë bashkëpunimin me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja statistikore e rritjes së kapaciteteve profesionale statistikore dhe me median për të rritur ndërgjegjësimin mbi përdorimin e statistikave zyrtare dhe edukuar audiencën për një përdorim e interpretim sa më të mirë të informacionit statistikor.



12. Të paraqesë të njëjtët tregues, si në tabelën e indikatorëve të performancës së paraqitur në çdo plan vjetor të punës të institucionit, ashtu edhe në tabelën e indikatorëve të performancës të paraqitur në çdo raport vjetor, që të ketë mundësi krahasimi me bazë të njëjtë.

13. Të zhvillojë kapacitetet profesionale statistikore të punonjësve dhe të masë indikatorët e performancës dhe eficiencës në kryerjen e detyrave e përgjegjësi të ngarkuara, si dhe të kontribuojë në zgjerimin e njohurive statistikore të statistikienët e agjencive të tjera statistikore.

14. Të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet homologe të vendeve anëtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të përditësohet me metodologjitë dhe praktikat më të mira statistikore të aplikuara, si dhe të përfitojë nga eksperiencat e institucioneve respektive.

Miraturar në datën 16.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP) PËR VITIN 2018

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;

- Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore dhe, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen e interesit publik;

- Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

- Duke vlerësuar hapat e rëndësishëm që janë ndërmarrë për rritjen e pavarësisë institucionale të KPP-së, përmes ndryshimeve të fundit ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit, për vitin 2018, në drejtim të:

- Miratimit të rregullave të hollësishme të procedurave, siç është dhe rregullorja e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPP-së, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe performancën e institucionit.

- Dhënies së asistencës së nevojshme ligjore në lidhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që prekin procedurat e prokurimit, koncensionet/ppp, ankandet e lejet minerare.

- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet partnere ndërkombëtare, kryesisht i orientuar në organizimin e disa trajnimeve dhe aktivitete të shkëmbimit të eksperiencave, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së, në lidhje me zhvillimet më të reja në mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik në vendet e BE-së dhe rajon, si edhe me mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe.

- Rritjes së të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit nga tarifat e ankimit të operatorëve ekonomikë, për të cilët në fund të procesit administrativ është vendosur mospranimi i ankesës së tyre.

Kuvendi kërkon që Komisioni, për vitin 2019, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Për të gjitha rastet e anulimit të vendimeve të autoriteteve kontraktore, të marrë masa, sipas natyrës së shkeljes së konstatuar, duke i referuar autoritetit përkatës, APP-ja për kundërvajtje administrative dhe prokurorisë për shkelje penale.

- Të marrë masa për standardizimin e vendimmarrjes dhe bërjen publike të tyre, me qëllim rritjen e efikasitetit të shqyrtimit të çështjeve, garantimin e barazisë, si dhe sigurimin e transparencës.

- Të publikohen në faqen web të institucionit, në fund të çdo viti, listat e procedurave ankimese, duke përfshirë fondet limite të këtyre procedurave, objekt ankimi, të cilat janë në proces gjyqësor ose ka përfunduar vendimmarrja për llogari të tyre.

- Të rritet bashkëpunimi me gjykatën administrative për sa i takon trajnimin të punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim



aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik dhe për t'u përballuar me numrin në rritje të ankimeve, në zbatim të rekomandimeve të lëna në progresraport.

- Të forcohen kapacitetet administrative të KPP-së, duke e bërë totalisht funksionale strukturën e miratuar nga Kuvendi, deri në fund të vitit 2019.

- Të bëhet transparente në vendimet e publikuara nga KPP-ja edhe procesi i votimit të anëtarëve të Komisionit, si dhe rastet e përjashtimit gjatë procesit të shqyrtimit ankimor të ndonjërit prej anëtarëve.

- Të plotësohet Regjistri Elektronik i Ankesave me elementet shtesë të nevojshme siç janë edhe dokumentacioni shoqërues i ankesës së Operatorit Ekonomik dhe vendimi i gjykatës nëse çështja ka kaluar për gjykim.

Miratuar në datën 16.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

VENDIM
Nr. 322, datë 15.5.2019

**PËR KRIJIMIN DHE PËRCAKTIMIN E
FORMËS LIGJORE DHE TË
STRUKTURËS SË PRONËSISË SË
KAPITALIT TË OPERATORIT
TË TREGUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Operatorit të Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë), si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, të ndarë financiarisht dhe ligjërisht nga

“Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., (më poshtë referuar si “OST”).

2. Kapitali fillestar i regjistruar i Operatorit të Tregut nuk do të jetë më pak se 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, e cila do të financohet nga OST-ja.

3. Në rastin kur persona të tjerë juridikë do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut, me anën e një procedure konkurrimi, në sipas pikës 1/2, të nenit 57, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, këto subjekte mund të jenë, si më poshtë vijon:

a) operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit (më poshtë referuar si “TSO”) të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë;

b) operatorë me aktivitet ndërkombëtar, me eksperiencë në operimin/menaxhimin e tregjeve të shkëmbimit të energjisë elektrike të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (më poshtë referuar si “Operatorët me Eksperiencë Ndërkombëtare” ose “OEN”);

c) subjekte pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike, me përvojë në tregtimin e energjisë elektrike në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë (më poshtë referuar si “Pjesëmarrësit e tregut të energjisë” ose “PTE”);

ç) institucione financiare ndërkombëtare (më poshtë referuar si “IFN”).

4. Struktura e aksionarëve që zotërojnë kapitalin, sipas pikës 3, të këtij vendimi, do të jetë:

a) TSO-ja, duke përfshirë këtu edhe OST sh.a., do të kenë të paktën 55,5% të kapitalit;

b) OEN-të mund të kenë jo më shumë se 24,5 % të kapitalit;

c) PTE-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit;

ç) IFN-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit.

5. Ngarkohet OST-ja për kryerjen e procedurave ligjore pranë organeve kompetente për regjistrimin e Operatorit të Tregut.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë



dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 9, datë 14.5.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË ADMINISTRIMIT TË TEKSTEVE
SHKOLLORE NË PËRDORIM FALAS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të organizojnë punën që në çdo shkollë, në fund të vitit mësimor, të kryhet procesi i vlerësimit dhe i administrimit të teksteve shkollorë në përdorim falas.

2. Nxënësit të dorëzojnë tekstet shkollorë të marra në përdorim, sipas aktit të dorëzimit, menjëherë me përfundimin e vitit mësimor. Akti i dorëzimit të teksteve shkollorë nënshkruhet nga drejtori i shkollës dhe nga mësuesi kujdestar. Mësuesi kujdestar bashkëpunon/koordinon me prindin e nxënësit apo përfaqësuesin ligjor të tij, për kthimin e teksteve nga nxënësit.

3. Komisioni i Administrimit të Teksteve Shkollorë në përdorim falas vlerëson gjendjen fizike të teksteve shkollorë të përdorshme dhe identifikon nevojat për tekste shkollorë të reja, për të cilat do të bëhet porositja sipas pikës 5, të udhëzimit të MASR-së nr. 24, datë 19.7.2018, “Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollorë për nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë”. Në regjistrin e krijuar nga çdo drejtori shkolle, sipas pikës 12 të udhëzimit të MASR-së nr. 24, datë 19.7.2018, “Për dhënien në

përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollorë për nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë”, të plotësohen shënimet përkatëse për çdo tekst shkollor.

4. Numri i teksteve shkollorë të vlerësuara si të përdorshme sipas këtij udhëzimi të jetë kriter vlerësimi, pjesë e performancës së institucionit arsimor (shkollës).

5. Shkollat, brenda 10 ditësh nga përfundimi i procedurave, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij udhëzimi, të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, numrin total të teksteve të papërdorshme për çdo titull. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe në MASR.

6. Në rastet kur nevoja për tekste shkollorë për vitin pasues tejkalon numrin e teksteve shkollorë të kthyer për t’u përdorur, shkolla do të bëjë porositë për tekstet shkollorë shtesë, pasi të jetë siguruar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, konfirmimi dhe auditimi i procedurës për çdo shkollë.

7. Shpërndarja e teksteve shkollorë të bëhet sipas planit të hartuar nga vetë shkolla, pas procedurës së vlerësimit të gjendjes fizike të teksteve shkollorë të kthyer nga nxënësit. Nxënësit e çdo klase të pajisen në të njëjtin përpjesëtim me tekste shkollorë të përdorura dhe tekste shkollorë të reja.

8. Tekstet shkollorë të vlerësuara si të papërdorshme të administrohen dhe të ruhen në shkollë për efekt kontrolli dhe auditimi, sipas udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Drejtori i shkollës është përgjegjës për marrjen e masave dhe administrimin e këtij procesi, deri në riciklimin e teksteve shkollorë të vlerësuara si të papërdorshme.

9. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të koordinojnë punën për administrimin e teksteve shkollorë dhe për plotësimin e kërkesave për tekste shkollorë shtesë për të gjitha shkollat në juridiksion të tyre.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Përgjithshme e



Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të arsimit bazë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

VENDIM
Nr. 437, datë 16.5.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU VLORË, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI
I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 16.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Nadire Fevri Meçorapaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Vlorë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 3 (tre) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Vlorë, janë numri rendor 1 (një) z. Agron Siri Shehaj, numri rendor 2 (dy) znj. Nadire Fevri Mecorapaj, numri rendor 3 (tre) z. Vangjel Jorgji Dule.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Vlorë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumëmemërore nga secila gjini. KQZ me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milion lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Vlorë duhet të zbatonte dhe sanksionin



plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Vlorë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 8 (tetë), 4 (katër) dhe 5 (pesë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 59, 60, datë 12.3.2019 dhe nr. 73, datë 20.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Vlorë, kanë shteruar.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 6 (gjashtë), 7 (shtatë), 9 (nëntë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 117 datë 4.4.2019, vendimin nr. 130 datë 9.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 92, datë 27.3.2019, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit z. Adriatik Bektash Alimadhi, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Agron Siri Shehaj.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor

10 (dhjetë), 11 (njëmbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 194, datë 23.4.2019, vendimin nr. 265 datë 10.5.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), 13 (trembëdhjetë) dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 223, datë 27.4.2019, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalia e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për Deputet me numër rendor 13 (trembëdhjetë), z. Ervis Genci Meço.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 2601 prot., datë 30.4.2019, z. Ervis Genci Meço, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Ervis Genci Meço, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin



Qendror të Zgjedhjeve më datë 13.5.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 3213, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Ervis Genci Meço, rezulton se: në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se me vendimin nr. Cs 24 Js 15987/17, Gjykata Amtsgericht Ingolstadt Gjermani, ka vendosur masën e dënimit 30 (tridhjetë) ditë konveruar në 300 (treqind) euro gjobë paguar, për veprën penale parashikuar në nenin 40/3 të Kodit Penal “Regjistrim Audio i paautorizuar i zyrarit.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pika 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3172 prot., datë 13.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3169 prot., datë 13.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për Deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ervis Genci Meço.

Në zbatim të nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu VI, pika 6 kreu V, pika 3, germa “b” e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura nga z. Ervis Genci Meço, kandidat për deputet në qarkun e Vlorës, përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 138/2015.

Në përgjigje të shkresës nr. V-1488/1 prot., datë 14.5.2019 zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e

Shqipërisë, z. Ervis Genci Meço, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi prima face i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas nenit 2, dhe nenit 4, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, rrethanat e paraqitura nga z. Ervis Genci Meço, nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kreu V, pika 2, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, është Prokuroria e Përgjithshme, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Sipas dispozitave të sipërcituara, procedura e verifikimit, sipas kësaj pike, nuk pengon vijimin e procedurave për zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e funksionit.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumëmemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Vlorë, i renditur me numër rendor 13 (trembëdhjetë), z. Ervis Genci Meço.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, nenin 175 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëpartiake të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, z. Ervis Genci Meço.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri

KËRKESË

Nr. 5121/1, datë 16.5.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i

bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dharmo’, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pasurinë e llojit “ndërtesë” (garazh), për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

- Vlera totale e shpronësimit është 400,297 (katërqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

Lista paraprahe e pronarit të pasurive, prone private, që shpronësohen nga realizimi i projektit “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Loni Dharmo’, Lushnjë”

Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Sajmir Ali Kurti	Ndërtesë (garazh)	8572	5/44-Nd	20	20	400,297.00	400,297.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë, me shkresën nr. 5064/1 prot., datë 5.7.2018
Vlera totale paraprahe					20		400,297	400,297	

NJOFTIM

Nr. 7263, datë 16.5.2019

PËR HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES

Marrëveshja e Lisbonës “Për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar” ka hyrë në fuqi më datën 8 maj 2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

VENDIM

Nr. 1, datë 21.5.2019

MBI SHFUQIZIMIN E
KOMPETENCAVE TË DELEGUARA ME
VENDIMIN NR. 244, DATË 22.12.2018,
“PËR DELEGIM KOMPETENCE TË
KRYETARIT TË KLSH-së”

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

- neni 24, pika 1 “Vazhdimësia pas përfundimit të mandatit” të kryetarit të KLSH-së;
- neni 25, “Përgjegjësitë e kryetarit”, germet “P” dhe “I”;



- neni 19, “Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë”, pika 1.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht:

- neni 164, pika 1, sipas së cilës: “KLSH-ja paraqet në Kuvend Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit”;

- pas kërkesës për tërheqje nga kompetencat e deleguara të zv.kryetares, znj. Lindita Milo, për arsye personale, datë 21.5.2019, nr. 347, dhe garantimit të vijueshmërisë normale të punës;

- në kushtet e zgjatjes në kohë të nominimit dhe përzgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014,

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara me vendimin e kryetarit nr. 244, datë 12.12.2018 zv.kryetarit të KLSH-së znj. Lindita Lati (Milo).

2. Ky vendim do t'i përcillet Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, kryetarit të opozitës.

3. Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2524, datë 8.4.2019, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja, i datëlindjes 31.8.1968, më datë 31.12.1991, si dhe caktimin si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme të motrën, shtetasen Eda Riza Bruzja, e datëlindjes 25.11.1958.

KRYETAR
Bujar Leskaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë